



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndërmjet:

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, (më tej: Univeristet) Univeristet publik, me adresë Rruga e Shkronjave, nr. 1, 20000 Prizren, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani,

dhe

PULSE Electronics, me adresë në, Adresa Rruga Kosta Novakoviç, Prishtinë përfaqësuar nga Drejtori zt. Butrint Bërdynaj.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është të rregullojë kushtet e bashkëpunimit midis dy palëve me qëllim të ofrimit të mundësive akademike të zgjeruara për studentët dhe stafin. Përmes këtij bashkëpunimi, PULSE Electronics, përmes dhurimit të paisjeve elektronike si laptop dhe kompjuterë, ka për qëllim mbështetjen e studentëve në edukimin dhe avancimin e tyre profesional dhe akademik.

Neni 2

Format e mbështetjes

- 1. PULSE Electronics**—mbi bazën e vullnetit shpreh gatishmërinë që të mbështesë studentët dhe stafin e Univeristetit si më poshtë:
 - Dhuron donacion 12 laptopë për studentë bursistë për vitin akademik 2023/2024.
 - Dhuron donacion 10 kompjuterë për Bibliotekën e Univeristetit;
 - Ofron zbritje 10% për studentët që bëjnë blerje në PULSE Electronics.
 - Ofron zbritje 15 % për personelin e Univeristetit që bëjnë blerje në PULSE Electronics.

2. Universiteti në kuadër të këtij bashkëpunimi do të :

- Vendos pllakën falenderuese për PULSE Electronics në Bibliotekën e Universitetit
- Do të ofroj hapësirat e Universitetit për nevojat promovuese të PULSE Electronics.
- Do të njoftoj studentët dhe stafin për kampanjat promovuese të PULSE Electronics.

Neni 3

Përgjegjësitë specifike

1. Universiteti dhe PULSE Electronics e caktojnë personin(ët) si përfaqësuesit e tyre përkatës për të koordinuar dhe menaxhuar aktivitetet sipas kësaj marrëveshje.
2. Për procedurën e përzgjedhjes së studentëve përfitues të laptopëve palët do të dakordohen së bashku.

Neni 4

Plotësimi dhe ndryshimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të plotësohet apo ndryshohet me përcaktimin reciprok të Palëve. Nëse njëra palë dëshiron të ndryshojë marrëveshjen, atëherë duhet ta njoftojë palën tjetër domosdoshmërisht me shkrim, duke përfshirë të gjitha detajet përkatëse.
2. Amendamentet do të hyjnë në fuqi sapo secila palë ta njoftojë tjetrën me shkrim për pëlqimin e saj, në përputhje me ligjet, politikat e secilës palë.

Neni 5

Zgjidhja e konfliktit

Çdo mosmarrëveshje ose konflikt që mund të lindë ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet ndërveprimit dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi nëse nuk ndërpritet nga asnjëra palë duke i dhënë palës tjetër një njoftim me shkrim, të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së planifikuar të përfundimit.
2. Çdo dispozitë e kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të dy palëve.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje palët pajtohen me kushtet të cilat janë cekur më lartë.


Prizren, 03.05.2025



Butrint Bërdynaj

Drejtori

PULSE Electronics



Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani

Rektor

Universiteti "Ukshin Hoti", Prizren